



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:103206
Datë: 07.06.2024
Numri i dokumentit: 05795273

A.C.nr.2113/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Bujar Muzaqi - Kryetar, Halide Reka dhe Hysni Bardheci, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit E.R. me vendbanim në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim Z.Z., avokate me seli në Komuna Ferizaj, kundër të paditurve V.S. me vendbanim në rr. "...", p.n., Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim N.A, avokat me seli në Komuna Prishtinë, M.V. ish nga Ferizaj, tani me vendqëndrim në Gjermani, të cilin e përfaqëson me autorizim F.I. me vendbanim Komuna Ferizaj, dhe Xh.A.R. nga Beogradi, të cilin e përfaqëson me autorizim G.R., avokat me seli në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, në çështjen kontestimore për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të parashtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, departamenti i përgjithshëm, divizioni civil, C.nr.777/17 datë 07.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit E.R. me vendbanim në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, departamenti i përgjithshëm, divizioni civil, C.nr.777/17 datë 07.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, departamenti i përgjithshëm, divizioni civil, me aktgjykimin C.nr.777/17 datë 07.12.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

"... I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit E.R. nga Ferizaj, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se në bazë të blerjes është pronar i

paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 78 m², e cila është pjesë e ngastrës kadastrale nr.2635-1, e cila shtrihet si në vijim: nga ana veriore në gjatësi prej 39 metra kufizohet me parcelën nr.2634-0 dhe në gjatësi prej 16.19 metra kufizohet me parcelën nr.2641-2, në anën lindore në gjatësi prej 7.76 metra kufizohet me parcelën nr.2635-4, në anën jugore në gjatësi prej 9.92 metra kufizohet me rrugën publike “...” dhe në anën perëndimore në gjatësi prej 18.64 metra kufizohet me pjesën e parcelës nr.2635-3, Zona Kadastrale Ferizaj, e regjistruar në emër të të paditurës së parë V.S..

II. OBLIGOHET paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paditurës V.S., t'i paguaj shumën prej 981,50 €, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm...”.

Kundër aktgjykimit C.nr.777/17 datë 07.12.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë paditësi për shkak të: shkëlqeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar të anulohet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose të ndryshohet aktgjykimi dhe të vendoset në mënyrë meritore.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura V.S., me propozim Gjykatës së Apelit që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi E.R. me vendbanim në rr. “...”, nr..., Komuna Ferizaj, ka paraqitur padi me datë 06.09.2017, kundër të paditurve V.S. me vendbanim në rr. “...”, p.n., Komuna Prishtinë, M.V. ish nga Ferizaj, tani me vendqëndrim në Gjermani, dhe Xh.A.R. nga Beogradi, për vërtetimin e pronësisë.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 05.11.2020, dëgjimit të palëve në procedurë dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.777/17 datë 07.12.2020, me të cilin aktgjykim e ka refuzuar në tersi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka arsyetuar se: “... Ligji që ka të bëjë me fitimin dhe humbjen e të drejtës së pronësisë parasheh mënyrat dhe kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të kaluar pronësia mbi një send të paluajtshëm nga një pronar tek tjetri. Në këtë drejtim edhe Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike (LMTHJP) që ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raporteve juridike në mes të palëve ndërgjyqëse, më saktësisht neni 20 përcaktonte se

pronësia fitohet “sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”, ndërsa neni 33 i po këtij ligji përcaktonte se “Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”. Neni 21 i LMTHJ liston mënyrat e fitimit të të drejtave pronësore të cilat mund të arrihen përmes ligjit: krijimi i një sendi të ri, me bashkim, me përzierje, me ndërtim në tokën e huaj, me parashkrim fitues. Deklaratave të dëshmitarëve G.R, A.M dhe E.R., Gjykata nuk ua fali besimin, pasi konsideroi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore, sepse përtej deklarimeve të tyre në këtë procedure, nuk u arrit të vërtetohet se paditësi e ka në posedim pjesën konstestuese, ndërsa në anën tjetër, e paditura e parë, V.S., ka provuar se posedon titull të fort juridik me të cilën e ka fituar të drejtën e pronësisë, siç është kontrata e shitblerjes me të paditurin e tretë (pronarin e mëparshëm juridik) Xh.R. Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike kontestimore. Përfundimisht gjykata vlerëson se paditësi me provat e ofruara, nuk arriti që para gjykatës të provojë se i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pjesën e ngastrës kontestuese prej 78 m2, në bazë të shitblerjes, andaj edhe kërkesëpadia e tij u desh të refuzohet si e pabazuar...”.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. I njëjti aktgjykim po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

I pabazuar qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me arsyetimin se dispozitivi është kundërthënës me arsyet e dhëna, dhe se aktgjykim mungojnë arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe ato të cilat janë dhënë janë të paqarta dhe kontradiktore, ngase sipas vlerësimit Gjykatës se Apelit dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, ku arsyetimi i dhënë është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, për faktin se gjykata e shkallës së parë del se ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve vendimtare si dhe për vlerësimin e tyre.

I pabazuar qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me arsyetimin se dispozitivi është kundërthënës me arsyet e dhëna, dhe se aktgjykim mungojnë arsyet lidhur me faktet

vendimtare dhe ato të cilat janë dhënë janë te paqarta dhe kontradiktore, ngase sipas vlerësimit Gjykatës se Apelit dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, ku arsyetimi i dhënë është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, për faktin se gjykata e shkallës së parë del se ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve vendimtare si dhe për vlerësimin e tyre.

Në nenin 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore në mënyrë decidive thuhet se : *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”.*

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike, dhe shkresave të lëndës, gjendjes faktike të vërtetuar, paditësi në bazë të ligjit, në bazë të veprimit juridik, si dhe as në bazë të trashëgimisë nuk i plotëson kushtet ligjore për ta fituar të drejtën e pronësisë.

Në nenin 7.1 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore në mënyrë decidive thuhet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

Të pathemeltë Gjykata e Apelit i vlerëson edhe pretendimet ankimore të palës ankuese për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase kjo gjykatë me shikim në shkresa të lëndës ka konstatuar se në bazë të provave të nxjerra gjatë shqyrtimit kryesor gjendja faktike del të jetë hetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e cila ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse, juridike dhe faktike lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pas ndikim në mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, të cilat si të rregullta dhe të bazuara në ligj në tërësi i pranon edhe gjykata ankimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu Gjykata e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës paditëse se kemi të bëjmë me shkelje të procedurës, dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës i njëjti është marrë në bazë të nenit 450 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, e në pajtim me nenin 195 paragrafi 1, pika (d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.2113/2021 datë 07.06.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi